

VENDIM
Nr. 281, datë 24.6.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 87, DATË 4.3.2021, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME LUSHNJË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 24.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 87, datë 4.3.2021, ‘Për licencimin e sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë, me shkresën nr. 330 prot., datë 25.5.2022, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor dhe teknik”, ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Lushnjë për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Lushnjë, me vendimin nr. 87, datë 4.3.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Lushnjë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i shoqërisë UK Lushnjë sh.a., z. Maldin Çela, ka mbaruar studimet e larta në degën “Inxhinieri elektrike” në vitin 2020.

5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Lushnjë sh.a., z. Klaidi Shkurti, ka mbaruar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Master profesional në degën Inxhinieri Mekanike, në vitin 2019.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lushnjë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Lushnjë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 87, datë 4.3.2021, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellë-Kanalizime Lushnjë”, bëhet ndryshimi, si më poshtë:

“Drejtues ligjor: Maldin Çela.”.

“Drejtues teknik: Klaidi Shkurti.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani